



INFORMACIONI PËR PUBLIKIM NË WEBSITE

Titulli:

Bursa “Lulëzojnë 2025” – Thirrje e Hapur për Studentët Bachelor nga e Gjithë Kosova

Përmbajtja (tekst i shkurtër):

Organizata TOKA ka hapur thirrjen për bursën “Lulëzojnë 2025”, një program i dedikuar për **të rinjtë 18+** nga e gjithë Kosova, që kanë potencial të madh por vijnë nga **rrethana të vështira sociale apo ekonomike**, dhe që duan të lulëzojnë në rrugën e tyre akademike, profesionale dhe personale.

Bursa “Lulëzojnë” përfshin **mbështetje financiare** deri në **1,000 euro (duke përfshirë taksat e të ardhurave personale)** për studentët e nivelit Bachelor, dhe mundësinë për t’u bërë pjesë e një komuniteti frymëzues të të rinjve të angazhuar.

KUSH MUND TË APLIKOJË?

Bursa është e dedikuar për të rinj 18+ vjeç që:

- Janë të regjistruar (apo do të regjistrohen në tetor 2025) në studime universitare të nivelit Bachelor (në Kosovë apo jashtë Kosovës);
- Kanë angazhim të dëshmuar në komunitet;
- Vijnë nga grupe të marginalizuara (vajza, të rinj nga zona rurale, me të ardhura të ulëta, studentë të brezit të parë, etj.);
- Kanë sukses të kënaqshëm akademik (nota mesatare mbi 4.0 në shkollë të mesme ose mbi 8.0 në universitet);
- Janë të motivuar për të kontribuar në komunitetin e tyre.

*Prioritet do t’u jepet **studentëve të vitit të parë në Bachelor në universitete publike!***

PËR ÇKA MUND TË PËRDORET BURSA?

- Pagesa të semestrit
- Qira dhe banim
- Ushqim dhe transport
- Librat dhe pajisje shkollore
- Teknologji (laptopë, internet, printerë)
- Kujdes shëndetësor dhe psikologjik, etj
- Mbështetje shtesë (opsionale) me produkte të dhuruara (si laptopë, bileta transporti, libra).
- Mundësi për punë praktike (opsionale) në organizata apo kompani që lidhen me fushën e studimeve.
- Promovim në rrejetet e TOKA-s për të rritur ndikimin dhe frymëzimin.

Afati për aplikim: 15 gusht 2025, ora 23:59

Apliko këtu: <https://toka-ks.org/eshte-koha-jote-te-lulezosh-apliko-per-bursen-lulezojne-2025>

Për më shumë informata apo ndihmë gjatë aplikimit, mos hezitoni të kontaktoni: lulezojne@toka-ks.org ose +383 38 704 560 / +383 49 569 800 / +383 44 442 470.